

Opština Vuçitër – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 66/25 11/04/2025

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

J u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **24 prill 2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 mars 2025.
2. Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet e komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.
3. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. “Shahin Krasniqi” në Vushtrri;
4. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. “Isa Boletini” dhe sheshit “Hasan Prishtina” në Vushtrri;
5. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. “Gj.K. Skënderbeu” në Vushtrri;
6. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës- ri rregullim të kufirit të pronës tek SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtrri sipas gjendjes faktike;
7. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 67/25 11/04/2025

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrië
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 11.04.2025

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **11 prill 2025** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2025.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
Por, për seancën e kuvendit, kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive t'i kenë shpjegimet analitike lidhur me disa kode buxhetore.
2. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. “Gj.K. Skënderbeu” në Vushtrri
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, pasi që posedon vlerësim nga ministria.
3. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. “Shahin Krasniqi” në Vushtrri.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Por, nëse deri në seancën e kuvendit nuk vjen vlerësimi nga ministria, të hiqen nga rendi i ditës.

4. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. “Isa Boletini” dhe sheshit “Hasan Prishtina” në Vushtrri.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Por, nëse deri në seancën e kuvendit nuk vjen vlerësimi nga ministria, të hiqen nga rendi i ditës.

5. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës- ri rregullim të kufirit të pronës tek SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtrri sipas gjendjes faktike.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Por, nëse deri në seancën e kuvendit nuk vjen vlerësimi nga ministria, të hiqen nga rendi i ditës.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB ___/25 ___/04/2025

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E III E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, PËR VITIN 2025, MBAJTUR MË: 27 MARS 2025

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:15**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Fakte Dushi, Fatmire Cecelia, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Mek Selaci, Jeton Gjaka, Spasoje Stefanoviç, Shkelzen Xhaferi, Refik Maloku, Ramadan Parduzi, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Nurie Halili, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Nasuf Aliu, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mungoi: Gentiana Rama.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 32 anëtarë të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetarja znj. Hava Mlinaku-Rruka, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Në fillim të mbledhjes, kuvendit mbajti një minutë heshtje për ngjarjet e fundit (vrasja e tre peronave) në Komunën e Vushtrrisë.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-në fillim të diskutimit shprehu ngushëllime për ngjarjet dhe jetë e humbura në ditë e fundit në komunën tonë duke uruar që këto ngjarjet të mos përsëritur më, pastaj deklaroi: Kryetar, nuk kemi mundësi të heshtim përballë punëve të bëra keq dhe papërgjegjësive nga ana juaj! Fatkeqësisht, kjo qeverisje tash e tri vjet nuk u solli qytetarëve asgjë tjetër përveç zhgënjimit. Bagerët që i mbajtët në rrugë për muaj të tërë po filloni t'i largoni, por puna sërish nuk është kryer. Gropat ende janë aty, sanimi i tyre nuk ka ndodhur, dhe qytetarët vazhdojnë të përballen me rrugë të dëmtuara. Nuk mund t'i mbyllim sytë para gjithë atij betoni dhe armature në zemër të qytetit. Beton, beton dhe më shumë beton! Gjithë ky beton do të arsyetohej nëse do të ndërtohej ndonjë urë; por jo! Në vend të zgjidhjeve funksionale dhe të menduara mirë, ju po e ngulfateni qendrën e qytetit me beton dhe po e privoni atë nga hapësirat e gjelbra. Ato dy pëllëmbë

park që i kishim, edhe ato po i zhdukni! Në vend që të mbillni drunjë dhe të zgjeroni hapësirat e gjelbra, ju po veproni krejtësisht ndryshe, duke betonuar çdo cep. Si do ta arsyetoni gjithë këtë beton, Kryetar? Mund ta themi hapur: jeni duke u tallur me paranë publike! Madje, do të ishte më e ndershme që ta ndryshonit edhe sloganin tuaj, sepse sloganin “Për qytetarët” nuk shkon më. Më mirë vendosni “Për pushtetarët”! Të gjithë kemi pasur rastin të vizitojmë qytete të tjera dhe të shohim se si janë ndërtuar sheshet e tyre: hapësira të organizuara mirë, me qasje të lirë për të gjithë qytetarët. Ndërsa sheshi ynë? Një kaos i vërtetë, një eksperiment i dështuar urbanistik! Gjithandej kemi prerje cezariene të rrugëve, të cilat kurrë nuk kthehen në gjendjen e tyre të mëparshme. Trotuaret janë të uzurpuara, të bllokuara, dhe askush nuk merret me to. Kompanitë ndërtimore janë duke i dëmtuar rrugët, përfshirë edhe ato që kanë qenë me bashkëfinancim nga qytetarët. Askush nuk po merret me këtë; ata po i mbarojnë punët e tyre, rrugët po prishen dhe mbesin ashtu. Por Kryetar, ju nuk po thyeni rekorde vetëm për projekte të lëna përgjysmë, por edhe për anulimin e vendimeve! Para disa muajsh morët vendim për shujta për punëtorët komunalë, një vendim për të cilin ju paralajmëruam se do të ishte i kundërligjshëm dhe ashtu doli. Më pas, në prag të fushatës zgjedhore, morët një tjetër vendim politik, duke ndarë nga 100€ për punëtorët komunalë, por edhe ky vendim u anulua. A mund të na tregoni sa vendime keni marrë në këto tre vite dhe sa prej tyre janë anuluar? Sepse me të vërtetë po thyeni rekorde në këtë drejtim! Për tri vite me radhë, kemi dëgjuar premtimin nga Kryetari për renovimin e Banesave të Bardha, banesave pranë Shkollës së Policisë. Ishte një premtim i qartë, një zotim para qytetarëve, por fatkeqësisht si shumë të tjera mbeti vetëm fjalë. Tash, kur po i afrohem fushatës zgjedhore, po shohim një tjetër ndryshim të papritur: jo vetëm që ky premtim nuk u realizua, por tani kërkohet edhe participimi i banorëve! Pra, jo vetëm që nuk arritët ta përmbushni një zotim që ishte përgjegjësi e juaja, por tani po përpiqeni t’ua bartni barrën qytetarëve. A nuk ishte ky projekt një angazhim i juaji? A nuk u zotuat se do ta realizoni? Kjo nuk është qeverisje e përgjegjshme, kjo është vetëm një lojë politike, ku premtimet lihen pezull për tri vite dhe kujtohen vetëm kur afrohen zgjedhjet. Prandaj sot, pyetja jonë është e thjeshtë: Nëse për tri vite nuk e mbajtët fjalën, si mund të presim që tani, në prag të zgjedhjeve, të veproni ndryshe? Qytetarët meritojnë më shumë!

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se ne anëtarët e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, kemi marrë besim qytetar për të punuar dhe për të marrë vendim në emër të qytetarëve, kështu vepruar edhe më datën 31.01.2025 kur votuam për aprovimin e një peticioni në fshatin Reznik, për shtrimin e rrugës me nr.868 ZK Vernicë, që për mendimin e tij ishte një vendim i ngutshëm duke vepruar pa i pasur të gjitha informatat relevante të rastit, dhe duke mos e ditur saktë se çfarë jemi duke votuar. Për këtë vendim është ushtuar ankesë nga pala e kundërt dhe është kërkuar që ky vendim të shfuqizohet nga ana e kuvendit. Pastaj ai njoftoj se ai nuk ka qenë në dijeni sikur beson edhe shumica e anëtarëve të kuvendit nuk kanë pasur dijen se në këtë rast të kësaj rruge ka pasur mosmarrëveshje mes palëve të përfshira në konflikt direkt pronësor personal e familjarë, (në rastin konkret tre anëtarë të njëjës palë janë duke vuajtur dënim me burg). Prandaj nëse kemi kontest kuvendi është dashur të mbajë një konsultim publik me ata qytetar gjë të cilën nuk e ka bërë. Më tej ish bordi i drejtorëve saktësisht më datën 29.01.2008 kishte sjell një konkluzion që kërkesa e Hasan Hasanit tash i ndjerë për ndërrim të paluajshmërisë i dërgohet në kompetencë dhe procedurë të mëtutjeshme Drejtorisë për Urbanizëm dhe Kadastër, e cila do të veprojnë konform dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë lami. Mandej ish kuvendi i komunës atëherë konkretisht me datën 30.04.2009 kishte marr vendim për ndërrimin e asaj prone, këto faktet ne nuk i kemi ditur atë ditë kur e kishim votuar atë vendim. Në saje të atij vendim ishte vendosur që Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër të ndërmarr veprime për zhvillim të negociatave që bëhet këmbimi i pronës mes komunës dhe Hasan Hasanit që të bëhet qasje në rrugën publike për banoret e lagjeve tani parashtrues të peticionit. Në këtë kontekst shtroj dh sqaroi se vendim i datës 30.01.2025 është krejtësisht i kundërligjshëm, dhe si ti tillë propozon që futet në rendin e ditës për shfuqizimin e tij. Kjo për faktin se kuvendi dhe komuna nuk mund të drejtohet me vendi që shkaktojnë pasoja për

qytetaret e atij lokalitet dhe shtron nevojën urgjente që të gjendet një zgjidhje e pajtimit të atyre familjeve, për ta ndalu siç tha gjakderdhjen vëllavrasëse. Në fund ceku dhe propozoi që të formohet një komision me përbërje nga kryetari i komunës dhe anëtarë nga të gjitha subjektet politike për pajtimin e atyre familjeve.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit- pas i përshëndeti gjithë të pranishmi fillimisht shprehu keqardhjen për ngjarjet e fundit që ndodhe në Komunës e Vushtrrisë ku disa familje u tronditën nga fatkeqësitë që ju ndodhen uroj që këto ngjarje të mos përsëriten më në të ardhmen. Në vazhdim në deklaratim jashtë rendit të ditës shtoj: të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrrisë, po hyjmë në muajt e fundit të Qeverisjes në ikje të Ferit Idrizit, qeverisje e cila fatkeqësisht nuk do mbahet mend për asgjë të mirë nga qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Nuk ka nevojë të priten edhe këta pak muaj për ta konstatuar atë që konstatohet gjerësisht nga qytetarët e Komunës së Vushtrrisë cep më cep të territorit të saj se Qeverisja e Ferit Idrizit është qeverisja më e dobët që e ka përjetuar Komuna e Vushtrrisë në këto 26 vite të pas luftës. Edhe qeverisjet e pas luftës me gjithë rrethanat e vështira mbahen mend së paku për diçka edhe sot e asaj dite që kur kanë qeverisur, Qeverisja Idrizi nuk do mbahet mend për asgjë pozitive dhe në dobi të qytetarëve ngase e gjitha ishte mashtrim, anulim, tentim gllabërim tokash, gënjeshtëri e pa skrupullt dhe dështim.

Të dashur qytetarë:

1. Ferit Idrizi E ka shndërruar Komunën e Vushtrrisë në një gërmadhë ku nga sheshi e deri tek secila rrugë hyrëse e dalëse nga qyteti janë kthyer në gërmadhë, gropa, kanale, shembje dheu e kubzash, shpërthim kanalizimesh, mbeturina, prishje ndriçimit publik etj etj.
2. E pati premtuar ujin për çdo familje për 6 muajt e parë të mandatit të tij ,sot që i kanë mbetur më pak se 6 muaj nga fundi i mandatit Ferit Idrizi nuk ka arritur të kyç në rrjetin e ujësjellësit as 6 lagje apo fshatra që nuk kanë furnizim me ujë, e madje me qeverisjen e tij kanë filluar të kenë reduktime edhe fshatrat që kurrë më parë nuk kanë pas reduktime.
3. Pati premtuar plan special për arsimin por në fakt e degradojë atë edhe më keq, ndaloj kiflet për nxënësit, politizojë skajshmërisht arsimin, në disa shkolla përfundon viti shkollorë pa e mbajtur nxënësit as edhe një orë në lënd mësimore të caktuara, u rrit dhuna dhe pa siguria në shkolla, nuk u ndërtua as një çerdhe e re dhe drejtorët e shkollave nën mandatin Idrizi filluan ti vulosin me vula të shkollave edhe tavolinat e kafeneve të qytetit.
4. E nisi me pompozitet projektin e sheshit dhe parkingut nëntokës ku jemi sot çfarë u arrit me këtë projekt?! U shkatërruan dhe u mbyllen po thuajse gjitha bizneset që me vite siguruan ekzistencën e familjeve tyre me mjaftë sfida nga afarëzimi biznesor përgjatë sheshit.
5. E nisi me pompozitet projektin e tregut për prodhuesit vendor ku jemi sot?! askund leje që lokacioni është tejet i papranueshëm për prodhuesit por as që duket në horizont përfundimi i projektit.
6. Për 4 vite mandate eksperimentojë me shëndetësi duke vendosur në krye të QKMF-së njerëz që e gjithë Vushtrria i njeh për deficite e dobësi profesionale e menaxheriale të cilët në vend se të rrisin shërbimet e reja shëndetësore e zgjerim të kapaciteteve Ferit Idrizi në shumicën e sektorëve të QKMF-së i kufizojë ato.
7. I gënjeu dhe mashtrij pa pikë respekti punëtorët e administratës së komunës se do ju paguante shujtat por në fund normalisht se nuk i kompensoi.
8. E shndërrojë NLP Përparimi në një Ndërmarrje Lokale Partiake Punësimi ku u stërmbush me punësimi pa kriter, ku punëtorëve nuk ju paguhen obligimet e trustit, ku blihen mjete motorike të amortizuara me mija euro mbi vlerën reale dhe pastaj mbesin në parking të

prishura dhe jo funksionale. Ku kositen 60 hektar bari në stinën e dimrit e ujiten lulet po ashtu.

9. Si në as një mandate tjetër, në mandatin e Ferit Idrizit nuk u ndan mjete pune për bujqit dhe fermerët duke e larguar nga prioriteti bujqësinë në një komunë tipike agrare siç është komuna e Vushtrrisë.
10. Themelohë dy drejtori të reja të cilat as vet Ferit Idrizi nuk e din se çka kanë për detyra të punës e madje madje as njëres e as tjetres nuk ju planifikojë as edhe një cent buxhet përpos rrogave të dy drejtorëve të emëruar në këto dy drejtori.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-diskutimi i tij u përqendruar në një vendim të datës 3 mars 2025 të nxjerr nga kryetari i komunës numër të protokollit 250/25 me të cilin lejohet pagesa nga buxheti i komunës për pjesëmarrësit ligjëruese në kumtesën shkencore në tryezën shkencore dhe anëtarë e Këshillit Organizativë me rastin e rënies heroike të dëshmorëve Zahir Pjaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu mbajtur me 31 janar 2025. Në mesin e pjesëmarrësve në konferencë që paguhen në shumën prej 200 € është edhe drejtori aktual i DKRS-ës z. Izet Miftari, e po ashtu i njëjti në emër të këshillit organizativ ka marrë edhe 300 € shtesë kompensim gjithsejtë në vlerë 500 € kompensim monetar. Mendojmë se në këtë rast drejtori për Kulturë z. Izet Miftari ka konflikt interesi sepse ka përfituar mjetet duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare. Bazuar në ligjet dhe praktikatat e mëhershme asnjëherë nuk janë paguar më herët anëtarë e këshillit organizativ. Po ashtu në mesin e historianëve pjesëmarrës në konferencë është edhe Shpresa Rama bashkëpunëtorja e ngushët e drejtorit aktual e cila me profesion nuk është historiane dhe për ta nderur edhe asaj i janë ndarë 200 €, në këtë rast kërkoj nga zyra ligjore të jap mendim se a ka pasur konflikt interesi drejtori i Kulturës, kur ka marrë këtë kompensim monetarë.

Izet Miftari, drejtor i DKRS-sqaroi se është e vërtet sa ka marr atë kompensim monetar në vlerë prej 500 €, por konferenca shkencore nuk ka qenë në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, por në kuadër të Departamentit të Historisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës të Komunës së Vushtrrisë dhe ai si drejtor nuk ka vërejtur se ka konflikt interesi, por nëse konstatohet se ka një konflikt të tillë ai është në gjendje që ti kthej ato para.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se me datën 28 maj 1999 në shtëpinë e Kahriman Pasomës janë ekzekutuar 68 shqiptarë nga forca paramilitare serbe. Për këtë çështje para disa muajsh është marr vendim që kjo shtëpi të shndërrohet në shtëpi muze të gjenocidit, andaj pyeti se a është zbatuar ky vendim i kuvendit.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së-duke ju referuar diskutimit dhe akuzave të anëtari të kuvendit z. Mehollit, sqaroi se rastet e fundit që kanë ndodhur në Vushtrri ku kemi pasur humbje të jetëve, nuk lidhen me çështjen e sigurisë nëpër shkolla, sepse personat që kanë humbur jetën nuk janë nxënës. Ai shtoi dhe vlerësoi se si komunë iu kanë qëndruar afër familjeve që kanë humbur familjaret e tyre. Më tej duke ju referuar statistikave zyrtare të raporteve policore konstatoj se në vitin 2019 raporti i policës konstatonte atëherë se janë gjetur të gjitha llojet e armëve të ftohta nëpër shkolla. Andaj kësaj nuk është e ndershme që tani të thuhet se është rritur pasiguria nëpër shkolla, kur raporti policor në vitin 2019 fletë për një gjendje alarmante të sigurisë nëpër shkolla. Po ashtu ai prezantoi edhe raportin aktual të policisë që fletë që gjendja aktuale është pakrahasimisht më e mirë sa i përket sigurisë nëpër shkolle, e po ashtu edhe raportin e vizitave sistematike nëpër shkolla, ku janë shpalosur një mori e masave dhe aktiviteteve që janë ndërmarr nga DKA, policia e Kosovës dhe akter tjerë të sigurisë në Komunën tonë e që kanë ndikuar në aspektin pozitiv lidhur me gjendjen e sigurisë nëpër shkolla.

Sylejman Mehollit, anëtar i kuvendit-tha se siguria nëpër shkolla nuk nënkupton vetëm sigurinë fizike, por është një gamë shumë më e gjerë e gjërave që i rrezikojnë jetën dhe shëndetin e fëmijëve

tani. Ai shtoj dhe njoftoj se në kushte intren pa dashur të politizoj kishte alarmuar para disa muajsh që në disa kioska afër shkollave tona shiten mjete dhe përbërës tjera që janë të tmerrshëm për shëndetin e fëmijëve tanë duke përfshirë edhe substanca tjera me efekt direkt të rrezikshme për nxënësit-fëmijët tanë dhe për këto paralajmërime të tij nuk është ndërmarr asnjë veprim nga komuna.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së-tha se në këto vend ku anëtari i kuvendit, njofton se ka hasur në këto mjete dhe substanca, janë kryer inspektime nga organet policore, por që nuk janë gjendur të njëjtat. Ai shtoj se denoncimi i tyre nuk njehe pozitë dhe gjithsecili ka të drejt dhe obligim ligjor që ti njoftoj organet kompetente për dukurit e tilla.

Izet Miftari, drejtor i DKRS-sqaroi se për çështjen e shndërrimit të shtëpisë së Kahrimon Pasomës në shtëpi muze të gjenocidit, janë ndërmarr të gjitha veprimet nga ana e Komunës së Vushtrrisë. Në këtë drejtim kanë dal në pah disa probleme që lidhen me futjen e kësaj shtëpie në listën e monumenteve historike nga ana QRTK-së, ata kanë kërkuar që zona në rreze prej 50 apo 100 metra objektet që janë në këtë perimetër të futen në listën e monumenteve dhe të njëjtit nuk kanë të drejtë të renovimit apo të restaurimit të tyre. Në këtë drejtim kjo qendër ka biseduar me ata banor që të njëjtit nuk kanë pranuar një gjë të tillë. Prandaj si komunë dhe bashkërisht me kryetarin e komunës kemi menduar që ne ta shpallim këtë objekt-muze pavarësisht se a do të, mund të futet në listën e monumenteve.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-kërkoj që të futet në rendin e ditës anulimi i vendimit 16/25 i datës 31.01.2025 lidhur me aprovimin e peticionit të banorëve të fshatit Reznik.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-pas i përshëndeti gjithë të pranishmit deklaroi: se në mbledhjen e datës 31.01.2025 kur ishte aprovuar vendimi për shtimin e rrugës në fshatin Reznik, kishte tërhequr vëmendje se ai komunitet atje ka probleme, dhe se një vendim i tillë është i ngutëshëm dhe i pa analizuar mirë. Çështja qëndron në faktin se kjo qeveri për shkak të paaftësisë për ti kryer punët e veta po ja gjuan përgjegjësit kuvendit për ta mbuluar mos diturin dhe inkompetencën e saj profesionale. D.m.th Komuna e Vushtrrisë me 14 drejtori tani nuk po është në gjendje ta kryej një punë të vetme, dhe për çështjen e një rruge me shtruar në zhavorr i dërgon përgjegjësin kuvendit gjë kjo e cila nuk ka ndodhu asnjëherë në historinë e Vushtrrisë. Tutje shtoi se jo për çdo gjë kuvendit ka kompetenca të vendos, dhe ceku se është jo në rregull të tentohet të përzihemi në çështjet që ju takojnë organeve tjera dhe në ato organe nuk i nënshtrohen vullneti të kuvendit siç janë ato të rendit dhe sigurisë. Në fund ceku dhe vlerëso se kjo qasje që çdo herë kur qeveria ka dilema për të marr një vendim ta dërgoj çështje në kuvend është logjike e gabuar dhe nuk qon gjëkund.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-konsideron se atë ditë kur është marr ai vendim për atë rrugë, nuk është se a kanë pasur krejtësisht të qarët se për çfarë janë duke votuar, dhe shtoj se është prezantuar sikur kemi të bëjmë me një rrugë të arave për të mundësuar që të punohen arat dhe logjika ishte që atyre banorëve-fermerëve të iu vihet në ndihmë për ti punuar tokat e tyre. Pastaj shtoj se atë ditë ishte dëgjuar vetëm njëra palë dhe pala tjetër jo, ndërsa me teoritë e zhvillimit lokale një projekt bëhet për qytetarët dhe duhet të merret mendimi i komunitetit. Në rastin konkret komunitetit ka ra ndesh me këtë parim dhe nuk kemi një ujudi apo pajtueshmëri lidhur me këtë projekt. Mandej shtoj se nuk është mirë që si rezultat i këtij vendim të vjen deri tek ndonjë konflikt tjetër,. Ai sugjeron që të dëgjohen të dyja palët, të tentohet të pajtohen nëse është e mundshme të arrihet një kompromis apo marrëveshje dhe deri në këtë fazë të mos veprohet.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-tha se është mirë që të mos ngutemi me marrjen e vendimeve pa u dëgjuar të gjitha palët që janë të involuara në këtë çështje dhe pa u marr edhe mendimi i kadastrit si organ i specializuar për këtë çështje. Nëse shkohet në shfuqizimin e këtij

vendimi atëherë çfarë do të ndodhe me vendimin e vitit 2009. Nëse veprohet kështu atëherë është mirë që të shfuqizohen të dyja këto vendime për këtë çështje dhe të provohet të gjendet një zgjidhje më e qëndrueshme.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-tha se nga diskutimet e deri tashme, shihet se shumica e anëtarëve të kuvendit nuk i kanë pasur informata e duhura, atë ditë kur kanë votuar kështu kanë ra në lajthitje. Prandaj është i mendimit se ky vendim duhet të anulohet dhe çështja të kthehet aty ku ka qenë dhe të provohet të gjendet një zgjidhje.

Pas diskutimeve, kryesuesja e kuvendit, e hodhi në votim propozimin e anëtarit të kuvendit z. Faton Hyesin për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.16/25 i datës 30.01.2025 lidhur me aprovimin e petitionit të banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Sylja, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik, kuvendit pas votimit me 29 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoj këtë propozim për inkorporim në rendin e ditës.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 shkurt 2025.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2025.
3. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024.
4. Propozim – vendim për Bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
5. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025.
6. Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.
7. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2024.
8. Propozim – vendim për ndryshim dhe plotësimin e vendimit për rritje të vlerës për shërbime të varrimit.
9. Propozim – vendim për përkrahje financiare për z. Endrit Latifi.
10. Propozim – vendim për shfuqizim të vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nr.656/06 i datës 09.11.2006.
11. Propozim – vendim për përkrahje financiare për z. Shkodran Imeraj.
12. Propozim – vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënien në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automermangë brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë.
13. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.
14. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.16/25 i datës 30.01.2025 lidhur me aprovimin e petitionit të banorëve të fshatit Reznik.
15. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 shkurt 2025

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 shkurt 2025.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2025.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” miratoi Procesverbalin nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2025.

3. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- tha se në shkollat e mesme, shkollat SHUM1 SHUM 2 e po ashtu edhe në çerdhen nr.2 nuk ka pasur renovime. Lidhur me raportin e shëndetësisë dhe raporteve të drejtorive tjera, ndoshta nuk kishte me qenë e domosdoshme që të sillen kaq shumë detaje të imta dhe të panevojshme.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-duke ju referuar titullit të këtij dokumente si raporti për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024, ndoshta është dashur që në këtë raport të kemi më së tepërmi informata dhe tabela dhe pasqyra financiare duke përfshirë secilin kod buxhetor nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, që i referohen investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve, pagave dhe mëditjeve komunaleve e kategorive tjera ekonomike. Kjo nuk ka ndodhur dhe ky raport është për keqardhje me nivelin e përgatitjes së tij sepse më tepër është një grumbullim i informatave nga drejtoritë komunale, dhe fletë për detaje deri në banalitet se si janë ndërruar bravat e dyerve të objekteve komunale, kjo e tregon nivelin e vërtet të kësaj qeverie dhe formës së raportimit të saj. Propozoi që ky raport të shtyhet për mbledhjen e ardhshme sepse i njëjti nuk i përmban elementet thelbësore të një raporti dhe është ofendim të kalohet kësisoj.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime të përgjithshme për raportin duke shtuar se ky raport është informues për të gjitha drejtoritë për punët që i kanë kryer gjatë vitit. Ndërsa për sa i takon pasqyrave financiare ato nuk aprovohen nga ana e kuvendit për shkak se të njëjtat i audton dhe i aprovon në një farë forme Auditori i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se nëse është ashtu siç po deklaroi Drejtori i Financave, atëherë i bie që ky dokument nuk duhet të emërtohet si raport por si informatë për punën e qeverisë komunale. Kjo për faktin se në vitin 2023 kemi aprovuar një buxhet që është dashur të zbatohet në vitin 2024 me të gjitha planet dhe projektet investuese kapitale dhe askund në këtë dokument nuk flitet për realizmin e këtyre projekteve.

4. Propozim – vendim për Bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se drejtoria ka përgatitur propozim-vendimet për bartjen e mjeteve nga viti 2024 në vitin 2025 konform Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, ku ceket mundësia ligjore për bartjen e këtyre mjeteve nga sistemi i menaxhimit të parasë publike. Shuma e mjeteve që është tejkualuar është 153,000.00 € që do të bartet në vitin 2025. Ndërsa vendimi tjetër ka të bëjë me bartjen e mjeteve në vitin 2025 në dy kategori ekonomike Mallra dhe shërbim në shumën prej 78,991.29 € dhe Investime kapitale në shumën prej 930,772.00 € Totali i mjeteve të

bartura 1,009,763.29 €. Tek tabela 4.2 shpërndarja e mjeteve bëhet përmirësimi i një projekti kapitali kodit i projektit 52290 rregullimi dhe pastrimi i Lumit Llap dhe Silnica shuma 80,000.00 €, zëvendësohet me projektin kodit 56362 rregullimi dhe pastrimi i Lumit Silnica Vushtrri-Smrekonicë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se jemi në dijeni se kjo pikë është obligim ligjor për tu sjellë në kuvend. Por shtoj se është fatkeqësi që shuma gati 1 milion euro nga të hyrat vetnake por edhe tjera që duhet të barten kanë dështuar që të shpenzohen në vitin 2024 dhe kjo tregon se çfarë qeverisje kemi në Komunën e Vushtrrisë. Më tej shtoj se është përmbaruesi priva ai që është duke ja marrë mjetet komunës, për mësimdhënës dhe këtë është duke e përdor kryetari i komunës për arsyetim para opinionit për dështimet e tij në realizmin dhe shpenzimin e buxhetit. Në fund tha se si grup do ta përkrahin këtë propozim, sepse është obligim ligjor, por shtoj se kjo tregon se çfarë qeverisje të dobët kemi aktualisht.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se sa i përket investimeve kapitale për bartje janë 930,772.00 €, por nëse i referohemi raportit për gjendjen ekonomike del se për investime kapitale në vitin 2024 kanë qenë të planifikuara më tepër se 8 milion euro, kurse janë shpenzuar vetëm 6,5000.00 € që i bie se 1,60000.00 € nuk janë shpenzuar dhe se realizimi në investime kapitale në vitin 2024 është 87%, andaj shtoj dilemën se ku kanë mbetur rreth 700,000 € dhe sipas kësaj del se 1,600.000 € kanë tepruar apo nuk janë shpenzuar. Tani i kemi për bartje vetëm 930,772.00 €, dhe ku kanë mbetur mjetet në vlerë prej 700,000 €. Prandaj kur kemi për bazë që shumë fshatra dhe lagje janë pa rrugë, pa ujë të pijes, teprimi i gjithë këtyre mjeteve tregon për një qasje tepër jo serioze dhe për një paaftësi qeverisëse.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se bartja e këtyre mjeteve vetnake tregon më së mirë se si pasojë e dështimit të realizimit të investimeve kapitale, po ngjanë që për projektet e vitit paraprak të paguajmë në vitin vijues për obligimet kontraktuale për projektet e vitit paraprak dhe kjo vërtetë është një dëmi i jashtëzakonshëm ekonomik, dhe po ndodh si rezultat i paaftësisë për ta shpenzuar buxhetin në realizmin e prekjeve kapitale. Nëse i kthemi kujtesë nga vitit 2022 kur i kemi aprovuar sipas viteve fiskale projekt-buxhetet dhe bashkë me të edhe projektet kapitale, që nga atëherë ka projekte që kurrë as që kanë filluar dhe kurrë nuk ka pasur një informatë në këtë kuvend se përse po ndodh një gjë e tillë dhe kush do ta barët përgjegjësin për këto projekte dhe për dështimin e tyre. Më tej ceku dhe përsërit se i ka bërë kërkesë komunës konkretisht Drejtorisë së Urbanizimit për çështjen e rrugës Qazim Morina e cili është në gjendje të tmerrshme, ashtu që ky projekt është ndarë në dy segmente dhe ka mbetur në një gjendje jashtëzakonisht të keqe. Ky projekt ka qenë me bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit dhe ata kanë shprehur pajtimin e tyre që bëhet një aneks kontratë për përfundimin e këtij segmenti të kësaj rruge. Prandaj kërkoj nga komuna respektivisht kryetari që ta dërgoj në ministri projektin si aneks që ata ta mbulojnë koston, ndërsa pjesa tjetër që i takon komunës të përfshihet tek të hyrat e bartura.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 7 vota “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 në kategorinë ekonomike si në vijim:

1.1 Investime kapitale.....153,327.69 €

Totali i mjeteve të bartura.....153,327.69 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë e tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë, tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga fondi (21) për vitin 2024 në vitin 2025 në kategoritë si në vijim:

1.1 Mallra dhe shërbime78,991.29 €

1.2 Investime kapitale.....930,772.00 €

Totali i mjeteve të bartura.....1,009,763.29 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë, tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit, ceku se ngjarët tragjike që ndodhen në komunën tonë janë më tepër se humbje jete, dhe kjo sigurisht se është një kampion apo një alarm për gjendjen dhe kahet që i ka marrë shoqëria jonë. Tutje shtoj se nuk pret dhe nuk mban shpresë që drejtori aktual i DKA-së të ndryshoj diçka pozitive në arsim. Pastaj shtoj se jeni duke u marr më tepër me gjëra periferike, dhe nuk jeni duke u marr me gjëra bazike për shoqërinë tonë për fatin e fëmijëve tanë. Në këtë kontekst shtroj si shumë më të nevojshme të bëhet një analizë më e thuktë për gjendjen në arsim në përgjithësi dhe për atë në Komunën e Vushtrrisë në veçanti, se sa të sjelli raporte sa kemi pasur mungesa të nxënësve dhe arsimtarëve edhe pse këto nuk them se duhet neglizhuar. Më tej shtoj se shkolla dhe procesi mësimor është koncept shumë më i gjanë se sa marrja e njohurive ajo është edukim dhe përgatitje për të ardhme të shoqërisë duke i përgatitur njerëzit për sfidat dhe duke mënjanuar pasojat që kohëve të fundi kanë ndodhur që për rezultat askush nuk është duke u marr me to. Fatkeqësisht ne nuk jeni duke u marr me esencën me thelbin e problemit të arsimit që është edukimi duke filluar prej fëmijëve parashkollor e duke vazhduar tek cikli i ulët. Qysh në klasën e dytë ne i ngarkojë nxënësit tanë me materiale, duke ikur nga esenca që është edukimi në parimet bazë për një shoqëri prosperuese. Në këtë relacion ai pyeti drejtorin e DKA-së, se cilat janë veprimet që ai i ka ndërmarr për ta ndryshuar gjendjen në arsim kur dihet se para një kohe një edukatoreje i është dhënë testi për provim pranues për tu punësuar dhe çfarë pritet më tej nga këta njerëz.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-duke ju referuar informatës në fjalë ceku se në gjysëmvjetorin e parë të këtij viti shkollor shihet se kemi disa aktivitete dhe kemi të arritura dhe kjo falë punës që është bërë nga ana e personelit arsimor të shkollave, nxënësve për çka i përgëzojmë dhe i inkurajojmë që edhe në të ardhmen të vazhdojnë më punë, sepse suksesit të nxënësve dhe të shkollave tona i gëzohemi të gjithë. Në informatë janë paraqitur edhe vështirësitë me të cilat me të cilat po përballen shkollat tona e sidomos shqetësuese është mungesa e mësimdhënësve të lëndëve deficitare si mësimdhënësi i lëndës së fizikë në shkollën SHUM1, mësimdhënësi të teknologjisë informative në shkollën fillore “Hajrullah Shala” në Akrahticë si dhe mësimdhënësi në Akrahticë, mësimdhënësi për gjuhë gjermane në shkollën “Migjeni” në Stanoc të Epërm, e që i bie se në tri shkolla këto lëndë për një gjysëmvjetor, nxënësit nuk e kanë mbajtur as edhe një orë të vetme. Sa i përket investimeve kapitale në faqen 8 të informatës, shihet se vetëm në tetë shkolla ka pasur investime kapitale nga 37 institucione publike sa ekzistojnë në komunën tonë, pra në 29 institucione tjera publike nuk ka pasur investime kapitale dhe nëse i shikojmë këto investime kapitale janë të vlerave simbolike me nga 200,300,500 deri në 2000 €, sa i përket suksesit të nxënësve në gjysëmvjetorit të parë, shihet se për klasë I-V kemi ngritje të suksesit krahasim me një vit më parë. Sa i përket klasave VI-IX shihet se kemi rënie të suksesit të shkëlqyeshëm për 0.57% po ashtu për suksesin shumë mirë kemi rënie për 0.08%. E njëjta dukuri është edhe në klasat X-XII në shkollat e mesme të larta ku kemi rënie të suksesit të shkëlqyeshëm për 0.42% dhe për suksesin shumë mirë kemi rënie për 1.5%. Edhe në këtë gjysëmvjetor shumë shkolla janë përballur me vështirësi si mungesa e inventarit shkollor, e lëndëve djegës, mungesa e fotokopjeve, tonerëve, printerëve dhe letrave për fotokopje dhe materialeve tjera shpenzuese që janë shumë të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. Një problem tjetër me të cilën mësimdhënësit përballen çdo janë përdorimi i telefonave nga nxënësit, edhe pse drejtori i DKA-së ka marr vendim për ndalimin e telefonave, ky vendim ose respektohet pjesërisht ose nuk respektohet fare. Një dukuri tjetër që ndikon në suksesin e nxënësve është edhe mungesa e teksteve për shkollat dhe drejtimet profesionale në profile të caktuar, i bëri thirrje drejtorit të DKA-së që të kërkojë nga ministria furnizimin me këto tekste. Problematikë tjetër është edhe numri i madh i mungesave të nxënësve, mungesa e trajnimeve të mësimdhënësve, numri i vogël i nxënësve në shkollat e fshatrave e problem të ngjashme. Në seancën e kaluar ka bërë pyetje dhe nuk ka marrë përgjigje të cilën e përsërit se si qëndron puna me punëtorët teknik të tri shkollave të mesme, sepse ata janë duke e kryer një punë jashtëzakonisht të mirë, kurse janë duke u trajtuar sikur punëtor të Përparimit dhe herë iu thuhet se janë punëtor të komunës e herë të N.P.L “Përparimi”, ata kanë mbetur dobët me paga dhe nga muaji i kaluar nuk kemi marr kurrfarë përgjigje për këtë çështje. Në fund tha se ekziston një vendim që në një pasues të tij shënon që sa herë që kemi rritje të pagave për punëtorët tjerë teknik të iu rriten paga edhe këtyre punëtorëve teknik të shkollave të mesme, kërkoj që ky vendim të sillet në kuvend që të njoftohet kuvendi lidhur me këtë çështje.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se kjo informatë është e punuar mirë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse pasqyron gjendjen aktuale të arsimit të komunës tonë. Në 16 faqet e saj në mënyrë logjike dhe të shkoqitur në kapituj janë prezantuar aktivitete, rezultatet, sfidat janë paraqitur mungesat e nxënësve, infrastruktura dhe investimet kapitale në shkollat e komunës sonë. Më tej përgëzoj DKA-në, për organizimin shembull të grave që jemi model edhe për komunat tjera në nivel të Republikës së Kosovës. Ai përgëzoj kryetarin e komunës, për investimet në fushën e arsimit për aplikimin e sistemit dualë të mësimi. Po ashtu është shumë mirë që kryetari i komunës dhe DKA kanë mundësuar bashkëpunimin me firma privatet si SPEEEX, për angazhimin e të rinjve kryesisht studentëve në punë në këtë ndërmarrje. Lidhur me çështjen e sigurisë nëpër shkolla

dhe veçanërisht për ngjarjet e fundit vlerësoi se këtu nuk mund të akuzohet DKA, sepse këto ngjarje janë duke ndodhur në krejt Kosovën.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se arsimit ka qenë dashur të jetë i një vëmendje të posaçme për shkak të rëndesës që ka dhe si çështje e interesit të përgjithshëm. Ngjarjet e fundit që ndodhen duhet të na shtyjme që të reflektojmë për gjendjen që jemi dhe të ndërmarrim veprim për përmirësim, sepse mbi të gjitha kemi nevojë për investim në edukim që është baza e zhvillimit shoqëror. Tutje shtoj se kemi disa indikator statistikor të cilët nuk po korrespondojnë me realitetin tonë shoqëro sa i përket cilësisë së vërtet në arsimin, por që mendon që këtu nuk është fajtor kryetari i komunës dhe drejtori i DKA-së. Për këtë gjendje mendon se duhet të kemi një reflektim i të gjithë mësimitdhënësve. Kjo për faktin se nëse e shikojmë indikatorin e suksesit del se për klasat I-V, sukseksi i shkëlqyeshëm është 65%, ndërsa menjëherë si të kalohet në nivelin e dytë klasat VI-IX sukseksi i shkëlqyeshëm del të jetë 24.32 % që është një rënie drastike. Në këtë kontekst vlerësoi se dikush është duke mashtruar me këto statistika, ose jemi duke ja bërë qejfin vetes sonë. Ky devijim i standardit, kjo rënie kaq rapide dhe e madhe vërtet është shqetësuese dhe ndezë alarmin se të gjithë edukatorët-mësimitdhënësit duhet të reflektojnë sepse nuk kemi një vlerësim real në sukses dhe ka deformim të kriterit dhe standardeve në vlerësimin e nxënësve. Ndërsa për të qenë akoma më flagrante është sukseksi i shkëlqyeshëm tek klasat X-XII që bie në 8% dhe kjo është vërtet për një analizë të mirëfilltë gjithëpërfshirëse se çfarë është duke ndodhur sepse këta indikator statistikor nuk janë duke na u përputhur. Pastaj forma se si arsyetohen mungesat nuk është normale dhe edhe këtu mendon se nuk janë fajtor qeverisjet. Mendon se për arsimin si fushë e rëndësishme vitale shoqërore duhet pasur një konsensus të përgjithshëm për të dal nga kjo gjendje që e ka kaluar sistemin tonë arsimor. Ajo çka e bënë përgjegjëse DKA-në është çështja, lidhur me politikat e rekrutimit të stafit arsimor, ku p.sh vetëm në shtator 2024 ka punësuar 31 mësimitdhënës, në ndërkohë tri konkurse i ka anuluar për shkak të mungesës së kandidatëve për lëndët deficitare fizikë SHUM1 përfshirë edhe shkollën e fshatit Ashlan, dhe kërkoj nga drejtori i DKA-së, se vendi i kujt nuk ka mundur të zëvendësohet për tri herë radhazi, dhe pse nuk është lajmëruar asnjë kandidat në lëndën e fizikës. Në fund tha se i kemi tri shkolla të cilat në tri lind kanë humbur komplet vitin në mungesë të mësimitdhënësve dhe në fakt kjo i bie se askush nuk mund dhe nuk guxon të marrë përgjegjësin që ata nxënës ti notoj sepse bënë shkelje ligjore dhe kjo rrjedhimisht në dërgon deri tek situata që ky raport sot të kontestohet në tërësi.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-tha se kjo informatë në tërësi pasqyron gjendjen e arsimit në komunën tonë. Tutje shtoj dhe kërkoj që nxënësit që marrin pjesë në garën e matematikës të kompensohen me një shumë monetare, ashtu që të stimulohet rritja e nivelit të këtyre garave, sepse një gjë e tillë nuk kishte ndodhur vitin e kaluar. Lidhur me mungesat e nxënësve vlerësoi se nëse merret për bazë numri i nxënësve, atëherë del se nuk kemi një numër jo të madh të mungesave. Në fund kërkoj nga DKA një raport të mësimitdhënësve që paguhen me honorarë apo punë jashtë orarit punë shtesë.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së-duke ju referuar materialit që është objekt shqyrtimi ceku se informata e përgatitur nga DKA është për periudhën apo për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2024-2025, dhe në brendinë e saj përfshinë punën e Drejtorisë së Arsimit, zhvillimet dhe aktivitetet, të arriturat, garat e diturisë dhe garat sportive, investimet kapitale, donacionet, sukseksi i gjysmëvjetorit të parë, numri i mungesave për të njëjtën periudhë të vitit shkollor 2024-2025. Pastaj shtoj se kjo informatë është si rezultat i kërkesave tuaj që dalin nga Plani i Punës së Kuvendit, dhe jashtë kësaj nuk ke edhe se çfarë të prezantosh. Lidhur me diskutimin e anëtari të kuvendit z.Maloku, duke cituar atë shtoj se: nuk e ka problem se a është i fundit a i pari në planet për të ndryshuar diçka në arsim, sepse me të vërtet e ka humbur atë që do të duhet të dominoj mes

nesh që është respekti kolegjial, profesional, politik dhe njerëzor. Pikërisht shpifjet e tij më kanë dërguar deri tek një derë që kurrë nuk e kisha menduar që mandati im të shoqërohet edhe me mjetet ligjore në gjykata. Për atë akuzë ai do të bindet me vulën e gjykatës kompetente se ishte shpifje e pastër 100% nga anëtari i Kuvendit z. Refik Maloku. Tutje shtoj se nëse nuk posedon vlera përtej pozitës si drejtor i DKA-së, asnjë vlerë tjetër nuk i duhet ta ketë të më veshur në personalitetin e tij në cilësinë e drejtorit. Andaj deklaroi se anëtarin e kuvendit të cekur me larët e ka respektuar maksimalisht, sepse në aspektin e drejtorisë që e udhëheq atë e ka kolegj, në cilëndo formë që e shikojmë drejtori i DKA-së është eprorë i tij dhe duhet të mbretëroj respekti. Politika nuk është dashur të na i verbojë sytë, që të shkohet deri në atë nivel të fryrjeve dhe shpifjeve në mënyrë që të cenohen edhe raportet ndër njerëzore. Zgjedhja e rrugës ligjore është ndërmarr me qëllim të evitimit të polemikave të ashpra dhe fryrjeve të vazhdueshme nëpër takimet zyrtare duke përfshirë edhe mbledhjet e kuvendit. Në të kundërtën e krejt kësaj apeli i anëtari të kuvendit z. Maloku në të përgjithshmen ishte pozitiv, profesional dhe ishte tamam një kontribut i duhur duke e tejkaluar edhe pozitën aktuale që e ka, për interesin e përgjithshëm për një arsim sa më cilësor. Tutje duke ju referuar mungesës së disa mësimdhënësve për disa lëndë të caktuar është gjë shqetësuese, ceku se kjo është e vërtetë sepse kjo gjë nuk po njuhë mandat dhe është duke na përcjellë në vazhdimësi, por konkurset shpallen me qëllim të plotësimit të vendeve të lira të punës, dhe shtoj se deri sa po raportojmë këto probleme veç se janë tejkaluar sepse janë plotësuar ato vende pune siç është rasti me shkollën e fshatit Akrahticë. Lidhur me ndalimin e telefonave në klasë, ka nxjerr një vendi, por nuk ka bërë ndonjë risi, sepse Ministria e Arsimit e ka nxjerr udhëzimin administrativ për një gjë të tillë, ndërsa DKA vetëm sa e ka përforcuar me vendim, këtë ndalesë. Ky vendim ka pasur efekt jashtëzakonisht pozitiv në aspektin e ndalimit të përdorimit të telefonave nga ana e nxënësve në orët e mësimin. Mungesa e teksteve shkollore për profilet deficitare, kjo çështje dhe shqetësim është i bazuar dhe këtë do ta adresojmë në Ministrinë e Arsimit. Çështja e punëtorëve teknik në tri shkollat e mesme, sqaroi se këtë punëtor janë në kuadër të N.P.L. "Përparimi" dhe shtoj se kjo ndërmarrje nuk është privat por është pronë e komunës në masën 100 % të aksioneve, dhe kryetari i komunës e ka top prioritet forcimin e kësaj ndërmarrje, duke përfshirë edhe rritjen e të ardhurave personale për punëtorët e kësaj ndërmarrje. Lidhur me referimin e anëtarit të kuvendit z. Mehulli, vlerësoi se pjesa e parë e diskutimit të tij ishte pozitiv dhe kontributor në aspektin e ngritjes së vetëdijes në vlerësimin e mësimdhënësve për të përmirësuar cilësinë e arsimit në komunën tonë. Lidhur me angazhimin e një mësimdhënëse të fizikës në shkollën e fshatit Strofc, bëhet fjalë për bashkëshorten e anëtarit të kuvendit z. Mehulli, ajo ishte e angazhuar në lëndën e fizikës në shkollën e fshatit Strofc, në vitin shkollor 2018-2019, por e njëjta sipas një zyrtari të asaj shkolle kishte deklaruar se nuk është e gatshme të vazhdoj të ligjëroj atje sepse rrugëtimi deri në shkollë është shumë i largët dhe për një gjysmëvjetor nxënësit e kishin humbur lëndën e fizikës. Në fund lidhur me pagesën e komisioneve nga mësimdhënësit për organizmin e garave të diturës, sqaroi se asnjë komisioni nuk është kompensuar.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me lëndën e fizikë potencoi se ai zyrtar që ka bërë deklarime se nuk ka pasur vijueshmëri nga mësimdhënësja e lëndës së fizikës, i themi se ai ka mungesë elementare të njohurive sepse punëmarrësi i përgjigjet punëdhënësit dhe nuk ka mundësi që dikush të refuzoj të shkoj në punë kur është në marrëdhënie pune sepse në të kundërtën sanksionohet. Pastaj shtoj se nuk patëm përgjigje për çështjen e rënies së përqindje së suksesit të shkëlqyeshëm, dhe për mënyrën e vlerësimit nga ana e mësimdhënësve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-deklaroi se drejtori i DKA-së nuk u përgjigj në çështjen e investimeve kapitale në shkollat e komunës ku vetëm në tetë prej tyre ka investime që është numër tepër i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të tyre. Më pastaj pyeti lidhur me Shkollën

private të Mjekësisë në Qytetin e Vushtrrisë, për të cilën asnjëherë nuk kemi pasur raport për gjendjen e saj, kërkoj që në raportin e ardhshëm të futen statistikatat edhe për këtë shkollë sa nxënës ka kjo shkollë, kush janë mësimitdhënësit cili është sukseksi i nxënësve e kështu më radhë.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-s qaroi se bazuar në udhëzimin administrativë përcaktohet se kush duhet të jetë pjesë e komisioneve për organizimin e garave dhe shtoj se lidhur me vlerësimin e nxënësve kemi defekte, sepse kemi nxjerr kuadro që nuk janë kredibile për ofruar mësimitdhënie cilësore.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së-s qaroi se çështje e rënies së suksesit është një shqetësim i përgjithshëm, dhe kërkon një analizë gjithëpërfshirëse për të gjetur një zgjidhje adekuate por kjo para se gjithash iu takon vetë mësimitdhënësve. Lidhur me shkollën private të mjekësisë në Vushtri, vlerësoi se DKA nuk ka kompetenca për sa i përket aspektit të angazhimit të kuadrove dhe investimeve në atë shkollë dhe për këtë nuk është dhënë ndonjë statistikë për të, nëse shihet e arsyeshme mund të përfshihen të dhëna për këtë shkollë në informatën e ardhshme.

6. Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.

7. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2024.

8. Propozim – vendim për ndryshim dhe plotësimin e vendimit për rritje të vlerës për shërbime të varrimit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me këtë çështje vlerësoi se i grup kuvendar janë të gatshëm ta mbështesin këtë kërkesë të Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri, me kushtin që në kuadër të këtyre shërbimeve dhe shpenzimeve të futet edhe shërbimi i hapjes së varrit nga ana këtij këshilli. Kjo është kërkuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe edhe kur ka filluar ky shërbim të ofrohet nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtri, ka qenë edhe shërbimi i hapjes së varrit, dhe më vonë është hequr ky shërbim, ndonëse, shumica e mjeteve si mbështetje nga komuna vetëm sa ka shkuar duke u rritur. Më tej apeloj tek kryetari i komunës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtri që në muajit në vijim të gjejnë hapësirë që edhe ky shërbim të ofrohet dhe të vihet si aneks marrëveshje për aprovim, ashtu që komuna ti rrit edhe pak mjetet dhe të ofrohet ky shërbim mjaft i domosdoshëm. Nëse kjo nuk është e mundur atëherë le të shkohet në variantin e subvencionimit të familjeve që kanë pasur rast vdekje me 100 apo 120 euro për mbulimin e shpenzimit të këtij shërbimi.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-tha se qytetarët tanë i paguajnë Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri, anëtarësinë dhe ne nuk e dimë se ku shkojnë ato mjete. Po ashtu kjo bashkësi ka edhe mjaftë prona tjera nga të cilat merr edhe qira. Prandaj a kemi drejtë ne si komunë që të kërkojmë raport për të hyrat që i ka Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtri, për të ditur se ku janë mbetur ato mjete që i kanë dhënë qytetarët tanë.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se ndanë mendimin e tij që këto tarifa jo që duhet rritur, por të njëjtat duhet ti zbriten Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri, kjo për faktin se qytetarët paguajnë anëtarësinë këtij këshilli dhe kurrë asnjëherë nuk kemi pranuar ndonjë raport nga ana e tyre për shpenzimin e këtyre mjeteve. Ai potencoi se përderisa nuk sjellët ky raport vota e tij do të jetë kundër dhe propozon që kjo tarifë të zbritet.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-propozoi që N.P.L. "Përparimi" në kuadër të veprimtarisë së saj ti bartet edhe hapja e varrit si shërbim, meqë kjo ndërmarrje ka një numër të konsiderueshëm

të punëtorëve dhe i njëjta ka kapacitete për të ofruar një shërbim të tillë, për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit-kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që në të ardhmen pala e cila parashtron kërkesë për kuvendit një përfaqësues të jetë prezent në mbledhjen e kuvendit. Tani jemi duke folur për një pjesë të konsiderueshme të parasë publike dhe po dalin pyetje dhe kërkesa për përgjigje dhe nuk e kemi përfaqësuesin që ka parashtruar kërkesë. Tutje shtoj duke cituar pikën 2 të arsyetimit, ku thuhet se duhet marrë për bazë gjendjen e rëndë të zyrtarëve të Bashkësisë Islame, me këtë a nënkuptohet se me këto mjete do të rriten pagat e tyre, sepse siç dihet pagat e tyre janë vërtet jo të nivelit të standardit në të cilin jemi duke jetuar, nëse kjo rritje e pagave ndodh ai do ta përkrah këtë propozim-vendim. Pastaj vlerësoi se për çdo para publike për secilën OJQ apo organizëm tjetër komuna, kërkon raport lidhur me mjetet që ia ka ndarë, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur asnjëherë me Këshillin e Bashkësisë Islame në Vushtri. Në këtë kontekst potencoi se ndoshta ligjërisht nuk kemi të drejt të kërkojmë raport për të hyrat e tyre, por për mjetet që i ka ndarë Komuna e Vushtrrisë për këtë këshillë sigurisht se ka të drejt të kërkoj raport lidhur me shpenzimin e atyre mjeteve.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-vlerësoi se një ndër punët më të mira që ka ndodhur kur LVV ka qeverisur, ka qenë edhe marrëveshja për kryerjen e shërbimeve të varrimit, dhe shtoj se në mbledhjen e fundit të KPF-së ishin dakorduar që të kërkohej një raport i detajuar se përse kanë kërkuar që të rritet vlera e tarifës së shërbimeve të varrimit. Pastaj ceku se ndoshta më mirë do të ishte të rritet më shumë kjo shumë e mjeteve financiare dhe të futet këtu edhe shërbimi i hapjes së varrit. Në fund deklaroi se e përkrahin këtë pikë të rendit të ditë dhe kërkoj nga qeverisja komunale që bashkë me Këshillin e Bashkësisë Islame të gjejnë një konsensus për të futur edhe shërbimin e hapjes së varrit në këtë memorandum të mirëkuptimit.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-vlerësoi se të gjithë në këtu në këtë mbledhje, kur i shikojmë këto shifra, konsiderojmë se janë shifra të larat, mirëpo për mos me dalë keq para opinionit publik dhe Bashkësisë Islame, ne jemi të gatshëm të votojmë rritjen e kësaj tarife në 270 €. Ai në emrin e tij personale ceku se do ta përkrahët këtë propozim-vendim sikur të futej aty edhe shërbimi i hapjes së varrit. Nëse nuk mundet Bashkësia Islame të ofroj një shërbim të tillë atëherë le ta lidhë një marrëveshje me Ndërmarrjen “Përparimi” për ofrimin e këtij shërbimi. Në këtë formë ai nuk është i pajtimi që ta votoj këtë pikë të rendit të ditës.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-sqaroi se për çdo muaj Drejtorisë së Shërbimeve Publike iu ofrohet raporti për numrin e të vdekurve nga ana e Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri dhe në saje të këtij raporti bëhet edhe pagesa nga ana e komunës.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 7 vota “kundër” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.99/22 i datës 28.04.2022 për shërbimet e varrimit në Komunën e Vushtrrisë, për rritet fetare që ofrohen nga Bashkësia Islame Dega në Vushtri, ashtu që rritet vlera e tarifës nga dyqind euro (200.00 €) sa është aktualisht, në dyqind e shtatëdhjetë euro (270.00 €).

2. Rritja prej shtatëdhjetë (70 €) euro e vlerës së kësaj tarife, bëhet si rezultat i rëndimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike, në kushtet e ngritjes së çmimeve dhe shtrenjtimit të kostos së jetesës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Propozim – vendim për përkrahje financiare për z. Endrit Latifi.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Endrit Latifi, nga fshati Pestovë i ndahen mjete financiare në shumë prej katër mijë euro (4,000.00 €), ndihmë financiare për shërim.

2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, Zyra e Kryetarit të Komunës, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 16024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Propozim – vendim për shfuqizim të vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nr.656/06 i datës 09.11.2006.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-sqaroi se me qëllim të zgjerimit të parkingut dhe hapësirës publike, po ndërmerren këto veprime për aprovimin e këtij vendim për të ia mundësuar QKMF-së shfrytëzimin e kësaj hapësire publike për nevojat e saj për parking.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet **vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 656/06 datë 09.11.2006 për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit banesorë për raste sociale dhe objekte tjera të infrastrukturës në Komunën e Vushtrrisë.**

2. Qëllimi i shfuqizimit të vendimit të cekur në pikën paraprake është krijimi i mundësisë që sipërfaqja prej 20 ari e cila gjendet në parcelën nr. 2253, vendi i quajtur “Selisht” fleta poseduese nr. 45 ZK- Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë të shfrytëzohet për nevoja të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Vushtrri.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, në Vushtrri.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Propozim – vendim për përkrahje financiare për z. Shkodran Imeraj.

Izet Miftari, drejtor i DKRS-së-paraqiti sqarimet lidhur me këtë pikë-kërkesë që ka të bëjë me mbështetje financiare në vlerë prej 5000 € për botimin e një libri për masakrën e Studimës që ka ndodhur me 2 maj 1999.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se krejt është në rregull të mbështet botimi i ndonjë libri e sidomos ai për masakrën e Studimës së Vushtrrisë. Por mirë do kishte qenë që ta aplikohet përmes thirrjes publike që të subvencionohet personi në fjalë për botimin e këtij libri. Andaj duke marrë për bazë që kjo kërkesë nuk është e arsyetuar dhe nuk janë respektuar procedurat e thirrjes publike, grupi kuvendar i LVV-së nuk e përkrah këtë kërkesë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se me gjithë respektin për punën e të gjithëve, kjo qasje është plotësisht e gabuar, për ndarjen në këtë formë të këtyre mjeteve pa respektuar procedurat e thirrjes publike. Më tej shtoj se kuvendi shpesh po bie në situata të rënda, kur po kemi kërkesa për shërim nga sëmundje e rënda. Andaj duke marrë për bazë se kjo kërkesë nuk është e arsyetuar si duhet edhe grupi kuvendar i LDK-së nuk e përkrah këtë kërkesë.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se pajtohet me parafolësit e tij dhe anëtarët e kuvendit nga radhët e AAK-së nuk e përkrahin këtë vendim.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-tha se për ngjarjen e dhimbshme të masakrës së fshati Studime të kryer nga forcat paramilitare serbe më datën 2 maj 1999, duhet shkruar nënë optiken shkencore të kokave qoftë në nivel Republikan apo edhe lokal që kanë kredenciale shkencore dhe kështu të memorizohet historia e asaj ngjarje tragjike për kombin e jo të shkruhet në këtë formë.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme ku të ndërtohet një ujdë për aprovimin e këtij vendimi.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 6 vota “për” 17 vota “kundër” nuk e aprovoj Propozim – vendimin për përkrahje financiare për z. Shkodran Imeraj.

12. Propozim – vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automerimangë brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” 1 votë “kundër” 4 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automerimangë në territorin e komunës, në këtë përbërje:

- 1.1** Arlind Gogolli, anëtar i Kuvendit;
- 1.2** Ramadan Parduzi, anëtar i Kuvendit;
- 1.3** Benjamin Shala, ekzekutivi i komunës;
- 1.4** Remzi Ahmeti, ekzekutivi i komunës;
- 1.5** Isak Hyseni, Shoqëria civile.

2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për shërbimin e transportit me automerimangë në pronën e përfshirë në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

4.1 Komisionit Vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për shërbimet e transportit me automerimangë në pronën e paluajtshme të Komunës e cila është dhënë në shfrytëzim që nënkupton:

4.1.1 Njoftimin publik i cili zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit;

4.1.2 Njoftimi publik, publikohet në faqen zyrtare të Komunës, në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe së paku në njërin nga mediat e shkruara dhe elektronike;

4.1.3 Njoftimi duhet të përmbaj të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e shërbimit me auto-merimangë, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit, arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave;

4.2 Pas pranimit të ofertave, Komisioni Vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik;

4.3 Komisioni Vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik, në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të shërbimeve të transportit me auto-merimangë;

4.4 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës si dhe të njëjtin ju dërgon palëve të përfshira në proces;

4.5 Komisioni Vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me auto-merimangë, ofertën e përzgjedhur e procedon te Kryetari i Komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin;

4.6 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit;

4.7 Komisioni, për punën e tij mbanë procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit;

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit Vlerësues.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

13. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.

14. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.16/25 i datës 30.01.2025 lidhur me aprovimin e peticionit të banorëve të fshatit Reznik.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.16/25 i datës 30.01.2025 lidhur me aprovimin e peticionit të banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Syla, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

3. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

15. Pyetje dhe përgjigje.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pyeti se kur do të bëhen ekzekutimi i pagesave për bletarë si dhe ekzekutimi i pagesave për litër të qumështit për fermerët e Komunës së Vushtrrisë.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-kërkoj të rregullohet çështja lidhur me çregjistrimin e anëtari të vdekur të një familje, duke u hequr dënim- gjoba komunale prej 50 € në rast të vonesë më tepër se një muaj.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-përcjelli shqetësimin e banorëve të lagjes tek flamurat, ku një ndërtesë ka gërryer dheun dhe tani kanë filluar të shemben edhe disa prona-parcela private. Kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit, dhe Drejtoria e Inspektiveve informatë me shkrim se ky person-biznes a i ka tejkalluar kushtet ndërtimore dhe ai ka respektuar standardet kur ka filluar të ndërtoj. Po ashtu ai ka respektuar rregullat dhe standardet ndërtimore të distancës mes objekteve dhe parcelave. Po ashtu kërkoj të informohet se cilat masa janë ndërmarr nga këto drejtori për evitimin dhe sanimin e asaj gjendje.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-kërkoj nga Drejtoria e Inspektimeve, që dal në teren dhe të inspektoj hapësirat publike që i takojnë Komunës së Vushtrrisë, për sa i përket vendosjes së kablllove në shtyllat elektrike, dhe po ashtu kur të lëshohet leja nga ana e KEDS-it, të ketë monitorim nga ana e organeve komunale, gjatë vendosje së atyre kablllove, sepse të njëjtat po paraqesin rrezik për qytetarët kalimtar në rrugë.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-pyeti drejtorin e DKA-së se përse subvencionet për sportin shkollor paguhen nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë dhe Sport e jo nga Drejtoria e Arsimit.

Mbledhja përfundoi në ora 13:25

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATA/DATUM/DATE	08.04.2025
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politik dhe Financa-Kuvendin Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
Nga/OD/FROM	Isuf Jashari, Drejtor i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2025

Të nderuar

Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2025 Drejtorja për Buxhet, Thesar dhe Financa ju prezanton Raportin Janar-Mars 2025 ,Raporti është i bazuar në planin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parasë publike për vitin 2025.

Shtojcë:

Raportet fizike

Emri i Komunës :	K.K.VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:	644								
Periudha raportuese	Janar - Mars 2025								
TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK									
Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese			Vjetore				Viti i kaluar
		Buxheti i planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhet të realizuar për PR	Buxheti i planifikuar për 2025	Buxheti i mbetur për 2025	Plani i reviduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2024
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11
Administrata dhe personeli	163	€	€	%	€	€	€	€	
Taksa administrative		30,000.00	13,335.00	44%	120,000.00	106,665.00	0.00	120,000.00	10604
TOTAL		30,000.00	13,335.00	44%	120,000.00	106,665.00	0.00	120,000.00	10,604.00
Inspeksioni	166	€	€	%	€	€	€	€	€
Pranime teknike		2,000.00	2,175.00	109%	8,000.00	5,825.00	0.00	8,000.00	4,585.00
Gjobat e inspeksionit		1,500.00	420.00	28%	6,000.00	5,580.00	0.00	6,000.00	1,250.00
TOTAL		3,500.00	2,595.00	74%	14,000.00	11,405.00	0.00	14,000.00	5,835.00
Buxhet dhe Fianca	175	€	€	%	€	€	€	€	€
Taksat e firmave		3,750.00		0%	15,000.00	15,000.00	0.00	15,000.00	9,750.00
Tatimi në pronë		304,606.75	179,866.43	59%	1,218,427.00	1,038,560.57	0.00	1,218,427.00	116,292.41
TOTAL		308,356.75	179,866.43	58%	1,233,427.00	1,053,560.57	0.00	1,233,427.00	126,042.41
Arsimi	900	€	€	%	€	€	€	€	€
Shitja e prodhimeve									
Participimi në çerdhen		17,500.00	38,511.00	220%	70,000.00	31,489.00	0.00	70,000.00	29,224.00
Shkolla e Mesme Teknike		5,000.00	16,862.00	337%	20,000.00	3,138.00	0.00	20,000.00	13,107.00
Shkolla e Mesme Profesionale		5,000.00	9,180.00	184%	20,000.00	10,820.00	0.00	20,000.00	8,565.00
TOTAL		27,500.00	64,553.00	235%	110,000.00	45,447.00	0.00	110,000.00	50,896.00
Gjeodezi dhe Kadastër	650	€	€	%	€	€	€	€	€
Tatimi nga Gjeodezia dhe Kadastër		25,000.00	17,130.80	69%	100,000.00	82,869.20	0.00	100,000.00	24,053.00
Qiraja nga objektet publike		13,250.00	7,165.84	54%	53,000.00	45,834.16	0.00	53,000.00	8,110.05
TOTAL		38,250.00	24,296.64	64%	153,000.00	128,703.36	0.00	153,000.00	32,163.05
Kulturë, rini dhe	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Palestra e sportit		125.00	650.00	520%	500.00	-150.00	0.00	500.00	84.00
Biblioteka		125.00	12.00	10%	500.00	488.00	0.00	500.00	
Shtëpia e Kulturës		125.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	
TOTAL		375.00	662.00	177%	1,500.00	838.00	0.00	1,500.00	84.00
Shërbime publike	180	€	€	%	€	€	€	€	€
Ndalja e veturave ne rrugë		750.00	2,345.00	313%	3,000.00	655.00	0.00	3,000.00	900.00
Regjistrimi i automjeteve		37,500.00	40,990.00	109%	150,000.00	109,010.00	0.00	150,000.00	37,880.00
Taksat e mbeturinave		211,500.00	179,648.80	85%	846,000.00	666,351.20	0.00	846,000.00	158,340.29
TOTAL		249,750.00	222,983.80	89%	999,000.00	776,016.20	0.00	999,000.00	197,120.29
Prokurimi									
Bujqësi	470	€	€	%	€	€	€	€	€

Ndryshimi i destinimit		12,500.00	25,646.21	205%	50,000.00	24,353.79	0.00	50,000.00	5,897.00
Leje pune									30.00
Shitja e drujve									
TOTAL		12,500.00	25,646.21	205%	50,000.00	24,353.79	0.00	50,000.00	5,927.00
Shëndetës	700	€	€	%	€	€	€	€	€
Participim		15,000.00	17,174.00	114%	60,000.00	42,826.00	0.00	60,000.00	13,400.50
Participim QPS		500.00	1,718.00	344%	2,000.00	282.00	0.00	2,000.00	1,015.00
TOTAL		15,500.00	18,892.00	122%	62,000.00	43,108.00	0.00	62,000.00	14,415.50
Urbanizimi	660	€	€	%	€	€	€	€	€
Lejet e ndërtimit		158,135.00	309,407.08	196%	632,540.00	323,132.92	0.00	632,540.00	130,645.88
leje mjedisore		25,000.00	62,319.86		100,000.00				31,107.78
Legalizim I Objekteve		6,250.00	4,437.44		25,000.00				804.24
Rrenim I objekteve									354.48
Shfrytëzimi i pronës P		6,250.00	344.60	6%	25,000.00	24,655.40	0.00	25,000.00	196.00
TOTAL		195,635.00	376,508.98	192%	782,540.00	347,788.32	0.00	657,540.00	163,108.38
	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Gjobat e pyjeve									183.00
Të hyrat tjera			-50.00	FALSE		50.00	0.00	0.00	
TOTAL		0.00	-50.00	FALSE	0.00	50.00	0.00	0.00	183.00
		881,366.75	929,289.06	105%	3,525,467.00	2,596,177.94	0.00	3,400,467.00	606,378.63
Sqarim: të hyrat e planifikuara janë 881,366.75 EURO,të realizuara janë 929,289.06EURO.									
Shprehur në përqindje realizimi është 105%.									

#REF!	K.K.Vushtrri																Viti I kaluar
#REF!	644																Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2024
Periudha raportuese	Janar - Mars 2025																
PËRMbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit																	
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE				VJETORE											
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2025	Buxheti i mbetur për 2025	Plani I reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar									
	4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11									
		€	%	€	€	€	€	€									
Finacimi nga huamarrjet	04		0%		0.00	0.00	0.00	6,042,376.21									
Granti Qeveritar	10	8,206,980.00	97%	24,137,294.86	16,174,944.84	0.00	24,137,294.86	201,610.15									
Të hyrat vetanake	21	929,289.06	74%	3,525,467.00	2,836,926.69	0.00	3,525,467.00										
Mjetet e bartura	22		#DIV/0!		-2,378.00	0.00	3,623.23										
Donacionet e brendshme	31	3,623.23	0%	3,623.23	3,623.23	0.00	#REF!										
Donacionet e jashtme	32	23,780.39	#REF!	23,780.39	#REF!	0.00	23,780.39										
TOTALI		9,163,672.68	94%	27,690,165.48	19,036,897.15	0.00	8,653,268.33	6,243,986.36									
Sqarim: Bazuar në përmbledhje e burimit te financimit buxheti I planifikuar është 9,169,672.68EURO,buxheti I realizuar është 8,653,268.33EURO.																	
Shprehur ne përqindje për periudhën Janar-mars 2025,sipas kategorive ekonomike realizimi eshte 94%																	

Komuna	VUSHTRRI													
Kodi	644													
Periudha raportuese	Janar - Mars 2025													
PËRMLËDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE														
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE				VJETORE						Viti i kaluar		
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2024	Buxheti i mbetur për 2025	Plan i reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Plani i reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Viti i kaluar			
	4	€	5	6 = 5/4*100 %	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11	€	€	€	€	
Paga dhe mëditje	111	3,537,731.08	3,518,283.68	99%	13,812,370.86	10,294,087.18	0.00	13,812,370.86	4,345,894.32					
Mallra dhe shërbime	130	2,544,623.14	2,525,786.81	99%	6,336,539.38	3,810,752.57	0.00	6,336,539.38	1,085,295.22					
Shpenzimet komunale	132	149,902.95	117,907.38	79%	639,625.00	521,717.62	0.00	639,625.00	117,420.82					
Subvencionet dhe transferet	200	948,813.27	872,932.75	92%	1,855,000.00	982,067.25	0.00	1,855,000.00	168,593.00					
Investimet kapitale	300	1,982,602.24	1,618,357.71	82%	5,046,630.24	3,428,272.53	0.00	5,046,630.24	526,783.00					
Rezerva				0%		0.00								
TOTALI		9,163,672.68	8,653,268.33	94%	27,690,165.48	19,036,897.15	0.00	27,690,165.48	6,243,986.36					
Sqarim: Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve është si në vijim:														
Planifimi është 9,163,672.68 EURO, realizimi i buxhetit është 8,653,268.33 EURO.														
Shprehur në përqindje realizimi është 94%														

Emri i Komunës :	VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:	644								
Periudha raportuese	Janar - Mars 2025								
PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2023	Buxheti i mbetur për 2025	Plani i reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Viti i kaluar Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2024
		€	€	%	€	€	€	€	
Zyra e Kryetarit	160	140,231.34	139,876.34	100%	474,168.09	334,291.75	0.00	474,168.09	86,339.34
Administrata dhe personeli	163	188,448.98	180,758.49	96%	511,239.50	330,481.01	0.00	511,239.50	101,158.43
Inspektimet	166	35,722.77	34,805.77	97%	201,417.19	166,611.42	0.00	201,417.19	30,475.00
Prokurimi	167	10,887.82	10,887.82	100%	63,184.95	52,297.13	0.00	63,184.95	13,350.86
Zyra e Kuvendit	169	66,314.67	66,314.67	100%	298,468.10	232,153.43	0.00	298,468.10	64,169.34
Komunal									
Buxheti dhe financat	175	50,851.37	50,519.37	99%	224,332.00	173,812.63	0.00	224,332.00	47,716.23
Mbrojtja civile dhe emergjencia	180	1,983,823.12	1,839,605.01	93%	4,636,561.38	2,796,956.37	0.00	4,636,561.38	892,359.63
Zyra lokale e komuniteteve	195	17,820.81	17,820.81	100%	98,336.94	80,516.13	0.00	98,336.94	13,915.24
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	1,162,999.90	1,058,977.14	91%	2,236,681.76	1,177,704.62	0.00	2,236,681.76	98,284.86
Geodezi dhe Kadastër	650	33,022.37	33,022.37	100%	123,217.34	90,194.97	0.00	123,217.34	19,764.24
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	692,601.31	564,734.05	82%	2,296,006.88	1,731,272.83	0.00	2,296,006.88	378,997.74
Shëndetësia primare	730	979,147.41	963,065.37	98%	3,205,726.29	2,242,660.92	0.00	3,205,726.29	569,241.10
Shërbimet sociale rezidenciale									
Kulturë, rini, sport	850	181,698.22	141,344.74	78%	715,459.71	574,114.97	0.00	715,459.71	55,269.18
Arsimi	920	3,548,456.70	3,481,412.49	98%	12,262,440.52	8,781,028.03	0.00	12,262,440.52	3,809,418.28
TOTALI		9,163,672.68	8,653,268.33	94%	27,690,165.48	19,036,897.15	0.00	27,690,165.48	6,243,986.36

Kodi I komunës:

Periudha raportuese

Janar - Mars 2025

KODI	Mallrat dhe shërbimet	2025	2024
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit		56.00
13131	Para xhepi-mëditje për udhëtime zyrtare brenda vendit	16.00	
13133	Shpenzimet e tjera të-udhëtimit zyrtar brenda vendit		
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit		
13141	Shpenzimet të vogla -para xhepi		1,129.00
13142	Akomodimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit		855.00
13143	Shpenzimet tjera e udhëtimit zyrtar jasht vendit	2,378.00	147.00
13310	Shpenzimet për internet	1,687.46	1,198.13
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	10,795.97	6,681.82
13330	Shpenzimet postare	182.10	308.90
13420	Shërbimet e perfaqsimi - avokaturë	9,471.70	8,919.67
13430	Shërbime të ndryshme shendetësore	4,584.94	1,708.98
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	4,607.45	1,799.00
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	1,715,542.48	794,289.97
13470	Shërbime teknike	9,061.38	43.05
13480	Shpenzimet e anëtarësimit	25,240.25	
13502	Telefonat		990.00
13503	Kompjuterët	1,257.00	
13509	Pajisjet e tjera	17,855.00	
13610	Furnizime për zyrë	16,583.10	15,944.77
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	16,852.75	10,715.65
13630	Furnizime mjekësore	9,362.51	21,672.43
13640	Furnizime pastrimi		14,695.51
13650	Furnizim me veshmbathje		
13710	Vaji	9,000.00	
13720	Nafte për ngrohje qendrore		930.90
13760	Dru dhe prodhimet e drurit për ngrohje	195,681.36	115,699.00
13780	Derivate për automjete gjenerator dhe makineri	9,596.52	13,050.48
13790	Gas natyror		60.00
13810	Avanc për para të imta	1,850.00	3,510.00
13820	Avanc për udhëtime zyrtare	6,488.97	1,006.20
13918	Provizion për tarifa të ndryshme	1,602.50	1,914.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	3,169.09	105.00
13951	Sigurimi i automjeteve	481.26	
13954	Kontrolli teknik	480.00	30.00
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	9,228.40	6,555.31
14020	Mirembajtja e ndërtesave		
14023	Mirembajtja e shkollave	32,500.00	996.00
14032	Mirembajtja e rrugëve lokale	5,016.85	27,800.00
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve	28,973.80	12,613.99
14110	Qiraja ndërtesa	450.00	450.00
14130	Qiraja - pajisjet	2,358.04	2,723.06
14160	Qiraja për automjete	11,442.24	
14220	Botimet e publikimeve		1,490.00

14230	Shpenzimet per informim publik		2,300.00
14310	Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	9,558.90	12,906.40
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	335,768.29	
14415	Pagesat për tarifet-vendimet gjyqësore- përmbartimore	16662.5	
13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME		2,625,786.81	1,085,295.22

14			
13210	Energjia elektrike	91,995.05	104,616.11
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	9,333.95	8,524.35
13230	Mbeturinat	8,724.00	2,194.00
13250	Telefonia fikse	2,354.38	2,086.36
13260	Pagesa-vendime gjyqësore	5,500.00	
14 TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE		117,907.38	117,420.82

20			
SUBVENCIONET			
21110	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE	79,334.86	12,300.00
21200	SUBVENCIONE PËR ENTITETET JOPUBLIKE	271,533.29	156,293.00
22202	TRANSFERE PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	269,870.00	
22298	PAGESAT PËR SHËRBIMET E VARRIMIT	7,000.00	
22299	QIRAJA PËR RASTET SOCIALE	600.00	
22300	VENDIMET GJYQËSORE	244,594.60	
20 TOTALI I SUBVENCIONEVE		872,932.75	168,593.00
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE		3,516,626.94	1,371,309.04

INVESTIMET KAPITALE

Përshkrimi	BUXHETI	SHPENZIMI PËR PERIUDHËN	MJETET E LLIRA	PËRQINDJA E REALIZIMIT TË BUXHETIT
RESP / PCLASS / PROJ	A	C	D	A - (C + D)
644 VUSHTRI	5,046,630.24	2,125,127.43	2,921,502.81	42.11
16324 ADMINISTRATA - VUSHTRI	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
56234 Rehabilitimi i kulmit të komunës	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
17524 BUXHETI - VUSHTRI	332.00	0.00	332.00	0.00
60405 ASFALTIMI I RRUGES PANTIN-ASHLAN	331.00	0.00	331.00	0.00
60413 RIPARIM SHF KRASNQ.POSHTME	1.00	0.00	1.00	0.00
18024 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - VUSHTRI	1,246.59	0.00	1,246.59	0.00
71935 RREGULLIMI I SHESHIT HSAN PRISHTINA	37.00	0.00	37.00	0.00
72228 RREGU RRUGES BAHRI KUQI SEG 1	375.52	0.00	375.52	0.00
83124 FOND BASHKFIN SHTR RR KUBEZA	2.00	0.00	2.00	0.00
86140 FONDI IBASHKFINANCIMIT SHTRURJA E RRUGVE ME KUBE	728.07	0.00	728.07	0.00
93129 PTK PER RR NE L.BUN SOP.F.SAMA	104.00	0.00	104.00	0.00
18184 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - VUSHTRI	737,177.58	300,000.00	437,177.58	40.70
46536 NDËRTIMI I URËS NË DOBËRLLUKË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
53182 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË PESTOVË	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
53193 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË GOJBULË	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
53220 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË STANOC TË EPËRM -STANOC TË POSHTËM	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
53226 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË MIHALIQ	31,000.00	0.00	31,000.00	0.00
53231 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË AKRASHTICË - BALINÇE	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
53259 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË PANITINË-OSHLAN	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
53463 NDËRTIMI I PIKAVE PRITËSE NË VUSHTRI	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
53603 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË KOLLË	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
54920 NDËRTIMI I URËS NE FSH LUMMADH-VUSHTRI	9,000.00	0.00	9,000.00	0.00
54942 RREGULLIMI I LUMIT TERSTENA-SILNICA VAZHDIM	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
54946 NDËRTIMI I STACIONIT TË POMPIMIT RRJETIT PRIMAR REZERVUJAREV	300,000.00	300,000.00	0.00	100.00
55564 Ndërtimi i urës në Akrahticë	9,000.00	0.00	9,000.00	0.00
56322 Ndërtimi i kanalizimit në Druar	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
56325 Ndërtimi i kanalizimit në Banjë	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
56330 Ndërtimi i kanalizimit në Shalë	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
56348 Ndërtimi urës në Miraqë me mure mbrojtëse	12,000.00	0.00	12,000.00	0.00
56358 Ndërtimi i vigut në Nevolan dhe shëtitore	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
56359 Ndërtimi i urës në Karaqë	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
56360 Ndërtimi i shtëpisë për komunitetin -Oshlam	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
56361 Ndërtimi i parkut rekreativ tek banesat e bardha dhe banesat	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
92080 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	3,985.65	0.00	3,985.65	0.00
92111 PERFORMANCA KOMUNALE 2021	6,285.73	0.00	6,285.73	0.00

93199 NDERTI PIK PRITESE PER AUTOB PRI-ZHI-BIV-STR	906.20	0.00	906.20	0.00
47024 BUJQËSIA - VUSHTRRI	1,336,323.00	823,853.26	512,469.74	61.65
46182 NGRITJA E PËMISHTEVE	991.00	0.00	991.00	0.00
49561 PROJEKTI NE BASHKEFINANCIIM IJE DONATORE	1,120,998.00	704,317.02	416,680.98	62.83
52290 RREGULLIMI DHE PASTRIMI I LUMIT LLAP-SILNICA	174,332.00	119,536.24	54,795.76	68.57
56362 Rregullimi dhe pastrimi i lumit "Silnica" Vushtrri-Smrkoni	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
81152 NGRITJA E SERAVE	2.00	0.00	2.00	0.00
66425 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - VUSHTRRI	1,834,560.00	640,388.36	1,194,171.64	34.91
53207 NDËRTIMI I RRUG "BEKIMI BERISHA ABEJA"	75,000.00	50,000.00	25,000.00	66.67
53262 NDËRTIMI I RRUG "AVNI SARAÇI" VICIANA	63,772.00	61,515.68	2,256.32	96.46
53274 RREGULLIMI I RR. "ISAK HALILI" ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLESE	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00
53276 NDËRTIMI I RRUG. "LUMNI SURDULLI"	60,000.00	0.00	60,000.00	0.00
53344 RIKONSTUIMI I BULEVARDIT „ADEMI JASHARI DHE LIDHJA ME	1,120,111.00	398,872.68	721,238.32	35.61
54750 REHABILITIMI I RRGËVE NË VERRNICË-SHALLC, AKRASHTICË, BUKOS	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
54775 REHABILITIMI I RRGËVE NË BIVOLAK, ZHILIVODË, STROC	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
54798 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË DUNNICË MAXHUNAJ, STANOC, LUM	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
54799 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË GRACË, PRELLUZHË	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00
54801 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË STUDIME E ULËT, CECELI, SAMADRE	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
54808 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË BAJNSKË, PASOMË, SLLATINË, BEGA	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00
54812 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË SHITARICË, PANTINË, HERCEGOVË	20,677.00	0.00	20,677.00	0.00
54814 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË BUKOSH, DOLAK, NOVOLAN	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
54819 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË DRUAR, MIHALIQ, REZNIK, SHALLC	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
54820 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË STROC, BEQIK, GLLAVOTIN, BIVOL	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
54834 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË BEÇIQ, DUBOC	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
54843 NDËRTIMI I RRGËVE LOKALE NË SKOQNE	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
55009 NDËRTIMI I RRUG "2 MAJI" ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLESE	100,000.00	70,000.00	30,000.00	70.00
56296 Ndërtimi i rrugës Sfarçak te varrezat	60,000.00	30,000.00	30,000.00	50.00
56305 Ndërtimi i rrugës Vesekoc - Sllakoc segmenti 3	50,000.00	30,000.00	20,000.00	60.00
74450 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDËTËSOR - VUSHTRRI	144,858.00	101,203.83	43,654.17	69.86
52719 BLERJA E PAJISJEVE MJEKËSORE QKMF VUSHTRRI	40,000.00	32,203.83	7,796.17	80.51
56309 Ndërtimi i radiologjisë QKMF Vushtrri	69,858.00	69,000.00	858.00	98.77
56313 Blerja e pajisjeve. INV-Objekte Shendetesore-Vushtrri	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
56320 Blerja e klimate inverter per QKMF ne Vushtrri	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
56440 Blerja e pajisjeve QKMF dhe AMF-Vushtrri	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
75617 SHËRBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRRI	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
53625 BLERJA E VETURËS PËR SHËRBIMET REZIDENCIALE	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
85024 SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRRI	248,141.02	59,955.95	188,185.07	24.16
51851 Ndërtimi pllakave për kujtimore në Pasomë	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
52825 RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I OBJEKTIT "ARKIVI I VJETËR" ISH F	94,141.00	10,000.00	84,141.00	10.62
54727 RREGULLIMI I MEMORIALEVE NË GLLAVOTIN, REZNIK, BEÇIQ, DUBOC,	79,000.00	49,955.95	29,044.05	63.24
54735 NDËRTIMI/RIKONSTRUIMI I FUSHAVE SPORTIVE MAXHUNAJ, LUMMADH,	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00
92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	0.02	0.00	0.02	0.00
92670 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET - VUSHTRRI	80,000.00	0.00	80,000.00	0.00

56334 Nderimi i çerdhes ne SHFMU "Enver Hadrj" Snirekonice	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
56337 Nderimi i çerdhes ne SHFMU "7 Mars" Bukosh	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
93690 ARSIMI FILLOR - VUSHTRRI	621,258.00	199,726.03	421,531.97	32.15
53024 NDERITIMI I SHFMU "MUSTAF VENHARI"	538,258.00	199,726.03	338,531.97	37.11
56340 Blerja e tabelave te mençura inv. A Z Çajupi Vushtrri	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
56345 Blerja e tabelave te mençur inv. Mustafe Venharin Vushtrri	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
56351 Tabela SMART per SHMU-1 dhe SHFMU "A Z Çajupi" Vushtrri	28,000.00	0.00	28,000.00	0.00
94890 ARSIMI I MËSËM - VUSHTRRI	22,734.05	0.00	22,734.05	0.00
56353 Tabela SMART për gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri	22,000.00	0.00	22,000.00	0.00
93222 RREGULLIMI I SHKOLLES BAHRI HAXHA	577.05	0.00	577.05	0.00
95104 FURNIZ MJETE PER PUNTOR SALDATOR-AKHUSTATOREVE	157.00	0.00	157.00	0.00
Totali i përgjithshëm	5,046,630.24	2,125,127.43	2,921,502.81	42.11



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PËR/ZA/TO:	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Departamenti për Vlersimin e Pronave të Paluajtshme
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për vlerësim të pronës së paluajtshme

Të nderuar,

Në pajtim me nenin 25, paragrafi 5 të Ligjit 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenin 30 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të bashkangjitur keni kërkesën si dhe dokumentacionin tjetër shtesë të nevojshëm për vlerësim të pronave të paluajtshme në ZK-le Vushtrri, prona për të cilat është filluar procedura e këmbimit, si vijon:

ZK-le Vushtrri

Prona e paluajtshme për vlerësim: Sipërfaqja prej **132 m²** pjesë nga parcela **P-70202016-06514-0**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **967 m²** zk Vushtrri pronë "Urban Grup" Sh.P.K me pronar Fisnik Maloku, sipërfaqe prej **117m²** pjesë nga parcela **P-70202016-02211-7** nga sipërfaqja e përgjithshme prej **973 m²** zk Vushtrri pronë e Komunës Vushtrri, sipërfaqja prej **15 m²** pjesë nga parcela **P-70202016-02210-9** nga sipërfaqja e përgjithshme prej **418 m²** zk Vushtrri pronë e Komunës Vushtrri.

Kërkesa dhe dokumentacioni tjetër i bashkangjitur, iu dërgohet në kompetencë dhe procedim të mëtejme.

Shtojcë: Kërkesa, fleta poseduese për pronat të cilat duhet vlerësuar për kompensim, kopja e planit dhe koordinatat .

Me respekt !



Propozuesi : Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi

Hartuesi: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë , Remzi Ahmeti

Lënda: Propozim-Vendim për këmbim të pronave.

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), nenit 24, nenit 25 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 29, 30 dhe 31 të Rregullores (QRK)nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më _____ 2025, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës - ri rregullim të kufirit të pronës në Rr. "Shahin Krasniqi" në Vushtrri sipas gjendjes faktike.

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Fisnik Maloku.
2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: Pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-06514-0**, në sipërfaqe prej **132m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **967m²** zk Vushtrri, pronë e Urban Grup SH.P.K me përfaqësues Fisnik Maloku , me pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-02211-7**, në sipërfaqe prej **117 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **973m²** zk Vushtrri, pjesë nga parcela **P-70202016-02210-9**, në sipërfaqe prej **15m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **418m²**, pronë e Komunës Vushtrri. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.
3. Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
4. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.
6. Ku vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjet (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuese e Kuvendit

Melihate Basholli-Latifi

ARSYETIM

